


E MËRKURA E MADHE. Lyerja e këmbëve të Zotit Krisht



E mërkurë, 16 prill 2025 - Kujtimi i ditës.

JAVA E MADHE E PASHKËS - KRESHMË

E MËRKURA E MADHE. Lyerja e këmbëve të Zotit Krisht.

- Lyerja e këmbëve të Zotit Krisht -

Të Mërkurën e Madhe përkujtojmë lyerjen me miro të këmbëve të Zotit tonë Jisu Krisht nga gruaja e përdalë. Gjithashtu përkujtojmë edhe mbledhjen e judenjve për të akuzuar Zotin Krisht nëpërmjet nxënësit të Tij, Juda Iskariotit.

Dy ditë para Pashkës, kur Krishti kishte shkuar në Jerusalem, dhe gjendej në shtëpinë e Simon lebrozit, iu afrua një grua e përdalë edhe ia lau këmbët Krishtit me miro të shtrenjtë dhe ia fshiu me flokët e saj. Miro kishte aromë të mrekullueshme dhe çmimi i miros ishte shumë i shtrenjtë rreth 30 dinarë. Për këtë nxënësit u habitën, sidomos Juda.

Apostujt e dinin gjithashtu se sa shumë zell kishte Krishti për lëmoshën ndaj të varfërve. Kjo grua leu me miro këmbët e Krishtit për ndjesë të mëkateve edhe

Perëndia i fuqishëm i zgjidhi asaj mëkatet e shumta pas aktit të pendesës.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)